

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	22. 06		2023
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-	060/04	-29834	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas –Municipality of Drenas
Zyra e Kryetarit



Data/Date: 12 qershor 2023

Nga/Od/From: Grupi Punues për Dëgjimet Buxhetore 2024-2026

Për/Za/To: Kryesuesin e Kuvendit Komunal të Drenasit, Milaim Hajdari

CC: Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Drenasit

Tema/Subjekat/Subject: Procesverbali nga procesi i dëgjimit të parë publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore [KAB] 2024-2026

P R O C E S V E R B A L

i dëgjimit të parë publik për:

KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE (KAB) 2024-2026

Pas themelimit të Grupit Punues për dëgjimet Buxhetore 2024-2026, sipas vendimit të kryetarit nr. 01-400/01-8586, i datës: 15.02.2023, dhe ftesës për pjesëmarrje në takim lidhur me dëgjimin publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore [KAB] 2024-2026, nr. 01-400/02-6624, i datës 05.06.2023, linqet në ueb-faqe të komunës: <https://kk.rks-gov.net/gllogoc/category/degjime-buxhetore/>; <http://konsultimet.rks-gov.net/consultationsList.php>; si dhe linku në Facebook: <https://www.facebook.com/100057638043139/posts/pfbid02ziLycdkkT5GarRJ7P2c9yiQDH37ykLt56P88vISCEPEYT2PZvDTwVbPMv6N9DVKqI/?mibextid=cr9u03>; u mbajt takimi i parë publik.





REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR 05/06/2023			
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlen
01-400/01	26624		



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit
Drenas, më 05.06.2023

F t e s ë

Për pjesëmarrje në takim lidhur me dëgjimin e parë publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026

Njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit, administratorë të vendbanimeve, përfaqësues të lagjeve, OJQ-të, shoqata e grave, shoqëria civile, biznese të Komunës së Drenasit, se më datën 12.06.2023, do të fillojnë dëgjimet buxhetore për të diskutuar Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026.

Ndërsa në muajin Korrik, do të fillojnë dëgjimet buxhetore për të diskutuar Draft-Buxhetin Komunal 2024-2026.

Korniza Afatmesme Buxhetore dhe Draft- Buxheti Komunal 2024-2026 janë të një rëndësie të veçantë për Komunën e Drenasit, prandaj ju qytetarë të nderuar, shfrytëzojeni të drejtën tuaj që të jeni pjesëmarrës aktiv në këto dëgjime publike, ku me propozimet dhe vërejtjet e juaja, ju do të kontribuoni në përmirësimin e cilësisë së jetës suaj.

Më poshtë gjeni vendin e mbajtjes së dëgjimit:

Dëgjimet publike për KAB 2023	Vendi, data dhe koha	Bartësit përgjegjës të dëgjimit	Bartësit mbështetës të dëgjimit	Vartësit përgjegjës për njoftim dhe vendin e mbajtjes së dëgjimit
Dëgjimi i parë publik me qytetarë për KAB-in Komunal 2024-2026	Komuna e Drenasit Salla e Kuvendit Më datë 12.06.2023 E Hënë, ora 11:00	Grupi Punues për dëgjimet Buxhetore 2024-2026 sipas vendimit të kryetarit 01 Nr.400/01-8586 i dt. 15.02.2023	Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit, Zyra e Informimit, Drejtorë të Drejtorive dhe njësitë tjera të komunës	Zyra për Informim, Drejtorët e Drejtorive, Zyra për Barazi Gjinore, përfaqësues të fshatrave, lagjeve dhe lokaliteteve që të njoftojnë qytetarët për pjesëmarrje

Ju mirëpresim!



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci



P R O C E S V E R B A L

Vendi i takimit	Data	Ora
Salla e Kuvendit, Komuna e Drenasit	E hënë, 12 qershor 2023	11:00

Takimi lidhur me dëgjimin e parë publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore [KAB] 2024-2026, i kryesuar nga udhëheqësi i zyrës së informimit, Bekim Dobra, u mbajt më 12. 06. 2023, në orën 11:00, në Sallën e Kuvendit të Komunës së Drenasit. Në takim, përveç bartësve përgjegjës, në përbërje nga: Grupi Punues për Dëgjimet Buxhetore 2024-2026 dhe bartësve mbështetës të dëgjimit, në përbërje nga: Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit, Zyra për Informim, Drejtore të Drejtorive dhe njësitet tjera të komunës; qenë të pranishëm edhe: Përfaqësues nga Qendra për Promovimin e Drejtave të Grave, OJQ, përfaqësues të fshatrave, lagjeve si dhe lokaliteteve të ndryshme të komunës së Drenasit.

Udhëheqësi i zyrës së informimit, Bekim Dobra, duke e hapur takimin i përshëndeti pjesëmarrësit në këtë takim, dhe ndër tjerash tha: I nderuari kryetari i Komunës, z. Ramiz Lladrovci, Kryesues i Kuvendit të Komunës, z. Milaim Hajdari, drejtore të drejtorive komunale, anëtarë të Kuvendit të Komunës, administratorë të fshatrave, përfaqësues të lagjeve, organizatave jo qeveritare, ju qytetarë.



Jemi mbledhur sot në këtë dëgjim buxhetor për të diskutuar Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026 si dhe Draft-Listën e Investimeve Kapitale për vitet 2024-2026. Ky dokument është përgatitur në bazë të Qarkores Buxhetore 2024/01 të lëshuar nga Ministria e Financave, e cila paraqet përmbledhjen e kërkesave fillestare të planifikimit e parashikimit për vitin 2024 dhe projeksionit të buxhetit për vitet 2024-2026.



Komuna me kohë ka bërë njoftimin dhe ftesën. Që nga muaji maj i këtij viti, pasi që kemi pranuar Qarkoren Buxhetore, kemi ftuar ekspertët, OJQ-të, Shoqërinë Civile dhe profesionistët për të kontribuar në hartimin e këtij dokumenti.

Komuna e Drenasit shquhet për transparencë e llogaridhënie, ndaj me kohë këto dy dokumente, draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026 dhe draft-Listën e Investimeve Kapitale, do të bëjë publike gjatë kësaj jave dhe ju qytetarë, mund të shihni e të jepni propozime në dëgjimet tjera që do të mbahen gjatë muajit Gusht dhe Shtator.

Ndjej për obligim të ju njoftoj me rregullat e takimit, që diskutimet për buxhet të jenë reciproke me qëllim që të bëhet një përmbledhje me interes për të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit. Të nderuar të pranishëm, fillimisht i jap fjalën kryetarit të Komunës, z. Ramiz Lladrovci, për të elaboruar draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2022-2024.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Të nderuar qytetarë, të nderuar administrator të fshatrave, duke ju uruar mirëseardhje ju falënderojë që keni gjetur kohë të jeni prezent këtu me ne, në këtë takim që është si hyrje në vazhden e dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2023-2026.

Sot në këtë takim do të keni mundësi të prezantoni projektet tuaja që janë në prioritet. Takime të tilla na ndihmojnë të përcaktojmë projektet më jetike për ju, që të i realizojmë në vitet e ardhshme.



Vlen të theksohet se në këtë takim nuk do të diskutohet për raportin e punës së kryetarit, pra nuk do të diskutohet për projektet që kanë përfunduar apo janë në proces. Në këtë takim diskutohen vetëm projektet që janë në prioritetet tuaja për tu implementuar në vitet ardhshme.

Natyrisht ky takim nuk do të jetë i fundit sa i përket identifikimit të prioritetëve tuaja, por që është fillimi i këtij procesi informues me ju si qytetarë dhe si përfaqësues të Bashkësive Lokale, lagjeve, familjeve etj.

Faleminderit për mirëkuptim.



Bekim Dobra, Udhëheqës i Zyrës për Informim: Të nderuar të pranishëm tani fjala është për ju, por paraprakisht lus që kur ta merrni fjalën, të prezantoheni për arsye të regjistrimeve dhe mbajtjes së procesit të takimit.

Fjalën e mori **Samedin Kiçina, administrator nga fshati Baicë**, ku kërkoj të punohet më shumë pasi që, nuk është punuar sa duhet në këtë fshat.

Bajram Qallapeku, administratori i fshatit Tërstenik 1 dhe 2: Përgëzoj kryetarin Lladrovci, por edhe komunën e Drenasit për punën dhe përkushtimin që po tregojnë ndaj qytetarit, dhe uroj që edhe në të ardhmen të vazhdohet kështu.

Murat Elshani, administrator i fshatit Gillobar: Përsëritet për të gjithë. Unë ju falënderoj për punën që keni bërë deri më tani. Nëse është e mundur, kanë mbetur edhe disa rrugica pa asfaltuar. Si dhe një kërkesë ndoshta edhe jashtë këtij tubimi, në lidhje me shtrirjen e ndriçimit me dy drita në lapidarin i cili ndodhet në varrezat e dëshmorëve.
Faleminderit.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Murat, në lidhje me ndriçimin e lapidarit është Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve, ajo e cila është përgjegjëse. Sigurisht se edhe ne mund t'i sjellim dy drita, ama për monumente të tilla është agjencia në fjalë.

Sa i përket rrugicave, të gjitha do të asfaltohen, përveç atyre që janë në pronë private. Pra, ato, së pari duhet të shpronësohen mandej të asfaltohen; përndryshe, ne si komunë nuk mund të bëjmë diçka konkrete.

Kadri Ajazi, administrator i fshatit Sankoc: Përsëritet për të gjithë, në fshatin Sankoc, është punuar dhe po punohet, dhe për këtë ju përgëzoj si komunë. Kemi ende edhe 1300 m rrugica nëpër fshat që duhet të asfaltohen, kanalizimi është duke u shtruar dhe aty ku ka mbetur të vazhdohet, trotualet nuk kemi në fshat ende., ndriçimi të bëhet aty ku ka shtylla të betonit, Sa i përket ujësjellësit rural që kemi atje në Golesh, nuk e di a janë kryer procedurat me kompaninë Kodra, edhe pse komuna më herët na ka ndihmuar me blerjen e pompave diku në vlerë prej 10,000 euro, ama ende nuk po u i mbulon të gjitha nevojat. Si dhe shtrimi i rrugës në drejtim të Krivovës.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Kadri, rrugën e kam premtuar dhe do ta bëjmë. Trotualet do të asfaltohen aty ku ka hapësira publike. Ndriçimi është duke u kryer diku 95% për këtë në tërë territorin e komunës. Sa i përket ndriçimit, në mbledhjen e ardhshme të kuvendit, Drejtori i



Ujësjellësit Rajonal Prishtina njësia në Drenas po refuzon ta lëshon ujin pasi që sipas tij në zonën e Komoranit dhe zonën tuaj nuk keni refuzuar ujëmatësit. Unë jam duke e përgatit edhe një padi ndaj tij, për diskriminim të qytetareve të komunës sonë. Ne si komune i kemi bërë gati të gjitha kushtet përfshirë edhe pompat, mirëpo ai është duke e diskriminuar qëllimshëm qytetarin.

Salih Berisha, përfaqësues i lagjes Berisha, Komoran 3: Përshëndetje të gjithëve, Në lagjen Obria kemi 67 shtëpi ende pa ujësjellës, operatori që është caktuar për kanalizim e ka dëmtuar ujësjellësin. Asfaltimi i rrugës së Komoranit 1, 2, 3, e 4 a është në projekt lidhja e rrugës për në lagjen Alushani për 2023 apo 2024, si dhe në lagjen Obria në Komoran të bëhet trotuari.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Trotuar, aty ku ka pronë publike do të shtrohet trotuari. Kompania që ka bërë dëmtimin ajo edhe duhet ta sanoj dëmtimin. Sa i përket projekteve i shihni në listë të cilën e keni para jush.

Hajrush Musliu, administrator i fshatit Shtrubullovë: Përshëndetje për të gjithë, në fshatin Shtrubullovë, është punuar shumë dhe për këtë jam falënderuar. Shtrubullova ka nevojë edhe për disa rrugica që të asfaltohen, si dhe kërkoj që ta kemi një fushë sportive në fshatin tonë, për faktin se jemi ndër fshatrat e pakta që nuk ka një fushë të tillë.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Hajrush, unë kam në dispozicion edhe së paku 3 fusha sportive për të investuar dhe nëse keni hapësirë të duhur, patjetër që do e marrim në konsideratë dhe mund të ndodhë që brenda këtij viti ta përfundojmë fushën sportive në fshatin tuaj.

Arbnor Istogu, administrator i fshatit Polluzhë: Së pari ju përshëndes të gjithëve, në planifikimin që parashihet të bëhet për 2024-2026 në fshatin Polluzhë kërkoj që të përfshihet rruga e cila lidhë lagjen Istogu dhe Kastrati, kërkoj të ketë trotuar pasi që e gjithë prona është publike. Nje kanalizim tek lagja Veliqi është problem i më hershëm ku edhe ka pasur ndalesa si pasojë e një mosmarrëveshje. Në lagjen Maloku dhe Bekolli janë jashtë ndriçimit si dhe fusha sportive po ashtu.

Zekë Kluna, përfaqësues i fshatit Poklek i Vjetër: Përshëndetje të gjithëve, unë kërkoj që të sanohet gropa septike e cila ndodhet mbi ujin e thartë, të bëhet ndriçimi nëpër lagje ku janë pa ndriçim si dhe puna e vigut për këmbësorë, të kihet parasysh pasi që është në nevojë të banorëve të fshatit tonë.



Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Zekë, nuk ka më gropë septike mbi ujin e thartë, d.m.th ai problem është sanuar, ndriçimi është duke u bërë. Sa i përket vigut për këmbësorë, nuk mundemi të bëjmë ende asgjë pasi që problemi qëndron tek pronat private. Pra, pa aprovimin e pronarëve aktual të pronave, nuk mund të bëhet diçka. Ju, siguroni pëlqimin e pronarëve të tokave andej dhe ne do të ndërmarrim hapat e duhur.

Ramadan Gashi, administrator i fshatit Llapushnik: Ju përsëritet të gjithëve, dhe falënderoj komunën për punën dhe angazhimin që keni bërë dhe po vazhdoni të bëni. Vlen të ceket projekti me madhori që është duke u zhvilluar, pra asfaltimi i rrugës Llapushnik-Berishë. E përmendët më herët që keni në dispozicion tre fusha sporti, dhe unë do të kisha dëshirë që ta kemi një fushë të tillë pasi që edhe ka nevojë, si dhe janë kushtet e duhura për një fushë të tillë. Ndriçimi mundësisht të bëhet edhe në tri lagjet e fshatit tonë, pasi që kemi edhe shtyllat prej betoni.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Sa i përket fushës sportive, nëse ka hapësirë të duhur, sigurisht se do ta shqyrtojmë mundësinë. Edhe ndriçimi do të bëhet në ato lagje.

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i komenteve, kërkesave, sugjerimeve	Numri i kërkesave të pranuar
Takimi i drejtpërdrejtë me të gjithë qytetarët e komunës së Drenasit të organizuar nga Kryetari i Komunës dhe grupi punues për dëgjimet buxhetore	12.06.2023 11:00-12:00	51	9	9

* Derisa KAB-i ishte në procesin e konsultimit, kërkesat në formën elektronike nuk janë pranuar.



















Bekim Dobra, Udhëheqës i Zyrës për Informim: Ju rikujtoj se kërkesat tuaja për projeksione të ndryshme, mund ti adresoni edhe me shkrim.

Nëse dikush tjetër nuk ka për të shtuar diçka, apo ndonjë kërkesë, duke ju falënderuar të gjithëve për pjesëmarrjen, ky takim përfundoni tani.

Me kaq takimimi mori fund në orën 12:00.

Dokumentet e bashkëngjitura:


Ftesa për pjesëmarrje;

Lista e pjesëmarrësve; si dhe,

Lista e projekteve kapitale 2024-2026.

Procesmbajtësi

Artor Hasani



Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave



LISTA E PJESËMARRËSVE NË DËGJIMIN BUXHETOR PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE 2024/2026
12.06.2023

Nr	Emri dhe mbiemri	Fshati/vendbanimi	Nr. Telefonit	Nënshkrimi
1	SMR. BAJRAMI	KISHVARE	044 201 296	Bajrami
2	RAMADAN SAGHI	ILAPUSHKIR	044 215 638	Saghi
3	MURAT ELSHANI	GLIOPAR	044-181-108	Elshani
4	HASRUKH MUSLIZH	SHTRUBULL	044-256-828	Muslizi
5	ARBION ISTOGU	POKIZHË	044-207-572	Istogu
6	JOHIS BAY	DRENAZ	044 249 7306	Bay
7	USUF MUSTAK	KAMUSË	044-874-148	Mustak
8	FETIMI N. ILI	KAMUSË	045-410 266	Fetimi
9	KADREZ TOHRI	DRENAZ	044-282-455	Tohri
10	QERIM BERRI	GODAN	044-174-382	Bერი
11	SALIH BERRI	KAMUSË	044-259-199	Bერი
12	HAZIME HALILAJ	DRENAZ		Halilaj
13	UKA HOJDEVA	ABRICEPANE	049 418.558	Hojdeva
14	XHEVDET DEMOLAJ	ABRICEPANE	044-367-019	Demolaj
15	SEMEDIN KICHA	BAIC	044 842 361	Kicha
16	ARBËR	BAZATI	044 808 333	Arberi
17	BOJAN	BAZATI	049-405438	Bojan
18	KADRI AJA	SANKOC	044-613-079	Aja
19	HE TEM AJA	SANKOC	045 892 908	Aja
20	KASTRIOT HOXHA	DAMANEK	044-362-592	Hoxha
21	ARBEN HAZINI	KROIKOVË	044-164-119	Hazini
22	JONAN PLEK	DRENAZ	099 977 802	Plek
23	ATRIU PROKSHI	PERBOO	044-120-287	Prokshi



24	FATOS PRKADH	SISTEM RRE	040-255-844	
25	BRITIR BAZA	KOMITETI E GJERE	04-321-069	
26	Plumet Syfe	Kindmush	045-282-523	
27	Kaltrina Gjata	Terstenik	048-442/772	
28	Fatke Klea	Pokleke	044-296-399	
29	Ilir Berisha	Glenorelle	043-889-317	
30	Arbenije Allende	Verboc	049-978-088	
31	Djellza Berisha	Llapushnik	049-678-315	
32	KUSHTRIM BASHKUTARI	DRENAS	041/374-929	
33	ENDRI GJAJARVA	VERBOC	048/258-819	
34	Kimete Qorri	Drenas	049-977-979	
35	Shqipëri Bujari	z. i ulte	049-978-523	
36	Enver Hoxha	Damand	044-181-176	
37	Antoni Hoxha	Shtrubell	04561 215	
38	ANDY MZIL	KOMORAN	049 221 880	
39	ALBERT SINANI	DRENAS	049 357 955	
40	MILAM HAJDARI	KRISHOR KUKENIOTI	049 978 333	
41	Bekim Dobra	Drenas	049 977 799	
42	Romiz Lladra			
43	Blenderina Gashi	POKLEK	049-789-624	
44	Djellza Berisha	Llapushnik	049-678-315	
45	Rezart Pralaj	Verboc	049-762-880	
46	Vlora Gjajari	Drenas	043 211 500	
47	NDRIÇIM BUJUPI	ARLLAT	043-608-354	
48	GRANT KARAGICA	GJANASULLI	049560 139	
49	KUSHTRINI BERISHA	LLAPUSHNIK	049-291-819	
50	VLORA KRASHI	DRENAS	049 010-234	
51	MAJLINDA GASHI	VERBOC	043799-988	
52				
53				
54				
55				
56				





KOMUNA E DRENAST
LISTA E PROJEKTEVE KAPITALE 2024-2026



Prog	Emri i Projektit	10 - BKK 2024	21 - THV 2024	Financimi Huanmerja	Totali 2024	V	Vlerësuar për 2025	Vlerësuar për 2026	Totali 2024-2026	Financimi Jashtëm
61180 - Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencë										
Infrastrukturë Rrugore										
451	Signalizimi Vertikal dhe Horizontal i rrugeve dhe vendimeve Drenas, Komoran, Terstenik Aftat BaçDobroshëc	-	50,000.00	0	50,000.00	30,000.00	30,000.00	110,000.00	0	0
451	Zgjerimi i kanalizimeve në Drenas dhe Komoran	-	5,000.00	0	5,000.00	5,000.00	5,000.00	15,000.00	15,000.00	0
451	Regulimi dhe mirëmbajtja e rrugëve të parkuqesve Drenas dhe Komoran	-	15,000.00	0	15,000.00	15,000.00	15,000.00	45,000.00	45,000.00	0
451	Riparimi dhe zgjerimi i vendit për autobus dhe ndalim Stulice Vetrov, Terstenik Aftat	-	20,000.00	0	20,000.00	20,000.00	10,000.00	50,000.00	50,000.00	0
SHPMCE-Infrastrukturë Rrugore		-	90,000.00	0	90,000.00	70,000.00	60,000.00	220,000.00	220,000.00	0
Drejtoria për Infrastrukturë Publike										
Infrastrukturë Publike										
451	Regulimi i shtrimit të lumit Drenica dhe Verbiça	-	25,000.00	-	25,000.00	20,000.00	20,000.00	65,000.00	65,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës Lipushnik-Berishë	150,000.00	150,000.00	-	300,000.00	400,000.00	200,000.00	900,000.00	900,000.00	0
451	Ndërtimi i rrugës bregut Organizues	-	5,000.00	-	5,000.00	60,000.00	60,000.00	125,000.00	125,000.00	0
451	Ndërtimi i parkut dhe shigjave për këmbësor, biçiklist në parkun e Kamencës Drenas	150,000.00	100,000.00	-	250,000.00	-	-	250,000.00	250,000.00	0
451	Ndërtimi i kolektorëve për grumbullimin e ujërave të zeza Drenas-Dobroshëc	400,000.00	-	-	400,000.00	300,000.00	300,000.00	1,000,000.00	1,000,000.00	0
451	Regulimi i rrugëve dhe ndërtimi i rrugës publike Drenas, Komoran, Aftat, Terstenik, Dobroshëc dhe Baç	200,000.00	150,000.00	-	350,000.00	330,000.00	330,000.00	1,010,000.00	1,010,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës dhe kuzmës në Drenas I,II,III dhe IV	166,117.00	83,883.00	-	250,000.00	300,000.00	500,000.00	1,050,000.00	1,050,000.00	0
451	Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit "Tehimi e Xheva Lladrov" Drenas	700,000.00	-	-	700,000.00	400,000.00	270,000.00	1,300,000.00	1,300,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugëve në Komoran I,II,III dhe IV	100,000.00	-	-	100,000.00	170,000.00	270,000.00	540,000.00	540,000.00	0
451	Ndërtimi i tumbave dhe Muzeja Mbrojtëse Drenas, Komoran, Aftat, Terstenik, Dobroshëc, Baç dhe Qikator e Vjetër	100,000.00	-	-	100,000.00	80,000.00	140,000.00	320,000.00	320,000.00	0
451	Ndërtimi, zgjerimi dhe riparimi i rrugëve të asfaltuar në Drenas	560,000.00	-	-	560,000.00	700,000.00	700,455.00	1,960,455.00	1,960,455.00	0
451	Ndërtimi, zgjerimi dhe riparimi i rrugëve të asfaltuar në Drenas	500,000.00	-	-	500,000.00	450,000.00	180,000.00	1,130,000.00	1,130,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës në fshatin Gllançellë Godanc	150,000.00	-	-	150,000.00	190,000.00	280,000.00	620,000.00	620,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës në fshatin Terstenik I,II dhe Qikator	80,000.00	-	-	80,000.00	150,000.00	100,000.00	330,000.00	330,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës në fshatin Pollek, Vjetër, Pollek, RI, Vasilev	120,000.00	-	-	120,000.00	180,000.00	100,000.00	400,000.00	400,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës në fshatin Abri Epërme, Terdec	80,000.00	-	-	80,000.00	150,000.00	100,000.00	330,000.00	330,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës në fshatin Dobroshëc, Qikator e Vjetër	120,000.00	-	-	120,000.00	170,000.00	212,545.00	502,545.00	502,545.00	0
451	Asfaltimi i rrugës Baç, Kalkovë, Damarë, Shtrubulovë	80,000.00	-	-	80,000.00	150,000.00	140,000.00	320,000.00	320,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës në fshatin Nektos, Kizharë	80,000.00	-	-	80,000.00	100,000.00	150,000.00	330,000.00	330,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës në fshatin Gradit dhe Likostan	80,000.00	-	-	80,000.00	100,000.00	140,000.00	340,000.00	340,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës në fshatin Aftat, Negro, Gjencica si dhe Bytyq	100,000.00	-	-	100,000.00	100,000.00	140,000.00	340,000.00	340,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës në fshatin Sankoc, Fushice e Epërme dhe Ulet	80,000.00	-	-	80,000.00	118,795.00	150,000.00	348,795.00	348,795.00	0
451	Asfaltimi i rrugës fshat Lipushnik Vetrov dhe Poluzhe	100,000.00	-	-	100,000.00	120,000.00	140,000.00	360,000.00	360,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës fshat Lipushnik Pollek-Vukov	80,000.00	-	-	80,000.00	120,000.00	219,000.00	419,000.00	419,000.00	0
451	Ndërtimi i kapacitetit të ujës në Drenas	200,000.00	-	-	200,000.00	341,055.00	500,000.00	1,041,055.00	1,041,055.00	0
451	Bashkëfinancimi i projektit për ndërtimin e ashpër	30,000.00	-	-	30,000.00	79,395.00	119,000.00	228,395.00	228,395.00	0
451	Hapja e Kanaleve kulluese për gjatë rrugës Drenas, Komoran, Aftat, Terstenik, Dobroshëc dhe Baç	25,000.00	-	-	25,000.00	80,000.00	119,000.00	224,000.00	224,000.00	0
451	Hapja dhe ndërtimi i rrugës tishore	53,656.00	-	-	53,656.00	467,769.00	700,000.00	1,221,425.00	1,221,425.00	0
451	Rrethja e QMF-AMF	50,000.00	-	-	50,000.00	-	-	50,000.00	50,000.00	0
451	Rendimi i AMF-Dobroshëc	30,000.00	-	-	30,000.00	-	-	30,000.00	30,000.00	0
451	Ndërtimi i shërbimit për komunitet- shërbime komunale për persona me aftësi të kufizuara	230,000.00	-	-	230,000.00	230,000.00	230,000.00	690,000.00	690,000.00	0





451	Objekte sportive	100,000.00		100,000.00	100,000.00	100,000.00	300,000.00		
451	Fusha Sportive dhe rekracion	190,000.00		190,000.00	200,000.00	200,000.00	590,000.00		
451	Ndërtimi i parkingjeve ne shkolla	40,000.00		40,000.00	40,000.00	40,000.00	120,000.00		
451	Ndërtimi i fustave te asistime sportive dhe mrehovave	50,000.00		50,000.00	30,000.00	30,000.00	110,000.00		
451	Ndërtimi i mjeteve sanitare si aneks i ri ne SHFAM " Ririnda "	30,000.00		30,000.00					
451	Ndërtimi i shkollës së re Rasin Kujna ne Drenas	25,000.00		25,000.00	213,017.50	700,000.00	938,017.50		
451	Instalimi i njezimeve qendrore	15,000.00		15,000.00	15,000.00	150,000.00	180,000.00		
451	Gjethimi i hapësirave publike mjellja e druve dekorativ shume vjeçare	43,000.00		43,000.00	43,000.00	36,591.60	122,591.60		
Totali - Infrastruktura Publike		5,367,773.00	513,883.00	5,881,656.00	6,816,031.50	7,676,591.60	20,374,279.10	0	0
611660 - Planifikimi Urban dhe Mjedisi		5,367,773.00	513,883.00	5,881,656.00	6,816,031.50	7,676,591.60	20,374,279.10	0	0
Planifikimi Urban dhe Inspektion									
620	Mitëmbajtja e sistemit te adresave, vendosja e tabeleve dhe numrave	5,000.00		5,000.00	5,000.00	5,000.00	15,000.00		
620	Rregullimi i kendej te vjeçrave per femije	10,000.00		10,000.00	10,000.00	10,000.00	30,000.00		
Totali - Planifikimi Urban dhe Mjedisi		15,000.00	15,000.00	15,000.00	15,000.00	15,000.00	45,000.00	0	0
611730 - Shëndetësia dhe mirëqenia sociale									
Shërbime shëndetësore primare									
721	Pajisje speciale mjekësore mbi 1000€	30,822.00		30,822.00	294,133.50	355,991.40	680,946.90		
721	Generator	20,000.00		20,000.00	0	0	20,000.00		
721	Veitura per vizita shpënjake	40,000.00		40,000.00			40,000.00		
721	Veitura zyrtare	60,000.00		60,000.00					
Totali - Shëndetësia dhe mirëqenia sociale		150,822.00	150,822.00	150,822.00	294,133.50	355,991.40	800,946.90	0	0
611850 - Kulturë, Rinia, Sport									
Shërbimet Kulturore									
820	Renovimi i objekteve sportive	20,000.00		20,000.00	20,000.00	20,000.00	60,000.00		
820	Blerja e librave	5,000.00		5,000.00	5,000.00	4,000.00	14,000.00		
Totali - Kulturë, Rinia, Sport		25,000.00	25,000.00	25,000.00	25,000.00	24,000.00	74,000.00	0	0
611920 - Arsimi dhe Shkencë									
Administratë - Gjiroç									
980	Digitalizimi i shkollave- Softwer (platforma digjitale) dhe pajisje perçelëse	60,000.00		60,000.00	60,000.00	10,000.00	130,000.00		
980	Kabinete ne shkolla	40,000.00		40,000.00	-	-	40,000.00		
980	Kendi i lojërave dhe rekreacion ne shkolla	40,000.00		40,000.00	40,000.00	-	80,000.00		
980	Furnizim me pajisje te TIK-ut	70,000.00		70,000.00	70,000.00	70,000.00	210,000.00		
Totali - Arsimi dhe Shkencë		210,000.00	210,000.00	210,000.00	170,000.00	80,000.00	460,000.00	0	0
Totali		5,367,773.00	1,004,705.00	6,372,478.00	7,390,165.00	8,211,583.00	21,974,226.00	0	0